



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 03.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.04.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “*Company Zuka Commerce SH.P.K*”, si dhe lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Lot 1 -Ndërtimi kanalizimit atmosferik tek Parku Baja dhe Lot 2 Ndërtimi I rrugëve dhe kanalizimi ne fshatin Zhegër-Gjiilan*” me Nr. të Prok: identifikues 651-24-2309-5-2-1, mori këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërishtë - si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “*Company Zuka Commerce SH.P.K*”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Lot 1 -Ndërtimi kanalizimit atmosferik tek Parku Baja dhe Lot 2 Ndërtimi I rrugëve dhe kanalizimi ne fshatin Zhegër-Gjiilan*” me Nr. të Prok: 651-24-2309-5-2-1, dhe

DT Version i Korigjuar dhe Njoftimi për Kontratë e AK-së, të datës 29.04.2024.

Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e dosjes së tenderi, duke e korigjuar në harmoni me LPP dhe po ashtu do të vazhdohet me këtë aktivitet .

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë “ *Company Zuka Commerce SH.P.K* “, me datë 29.04.2024, ka parashtruar kërkesen për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Lot 1 -Ndërtimi kanalizimit atmosferik tek Parku Baja dhe Lot 2 Ndërtimi I rrugëve dhe kanalizimi ne fshatin Zhegër-Gjiilan*”

me nr.identifikues 651-24-2309-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 22 521 Autoriteti Kontraktues me datë 03.05.2024 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga " **Company Zuka Commerce SH.P.K** ", Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara:

Pretendimi nr. 1 :

FTD - Kërkesa 1 : Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim I kanalizimeve), në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale për Lotin 2 prej 280,000.00 € së pari është tejkaluar vlera e kërkuar në raport me vlerën e parashikuar të këtij Lot-i.

Përgjigje rreth Pretendimit nr. 1 :

Duke u bazuar sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik vlenë të ceket se pika 8. Kriteret e përzgjedhjes, ku specifikohet qartë se:

d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur Llogaritë e audituara mund të kërkohen vetëm për 3 vitet e fundit.

Nëse kompania është themeluar para 1 ose 2 viteve për shembull kompania nuk mund të refuzohet për shkak se ka llogarite e audituara për vetëm nje ose dy vite. Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Kërkesa për qarkullim duhet të shprehet detyrimisht në shifra dhe duhet t'i referohet maksimum tri viteve të fundit financiare. Vitet e tilla financiare duhet të përcaktohen qartë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje. Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Andaj pretendimi ankimor i kësaj pike aprovohet dhe AK – Autoriteti Kontraktues do bëjë Korigjimin e DT si dhe Njoftimit për Kontratë në harmoni sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik.

Pretendimi nr. 2 :

Si dhe duke analizuar paramasën e këtij Lot-i (2) kemi vërejtur që 95% e pozicioneve në paramasë kanë të bëjnë me ndërtim të rrugëve e jo me kanalizim. AK sipas paramasës dhe normativave ligjore nuk do të duhej të kufizonte kërkesën vetëm në ndërtim të kanalizimeve por duhet të përfshijë të gjitha punët e natyrës së ngjajshme.

Ju lutem përmirësojeni këtë kërkesë duke e përshtatur me pozicionet e punëve në paramasë, pra me kontrata dhe referenca për ndërtim të rrugëve sepse kjo kërkesë e juaja është jo e arsyeshme me objektin e kontratës.

Përgjigjia e AK lidhur me këtë pretendim është se :

Ne si AK – Autoritet Kontraktues duke ditur natyrën e punës që do punohet është konstatuar që në këtë aktivitet të Prokurimit figuron edhe Ndërtim të kanalizimit. Ku, bazuar në këtë është parë e arsyeshme që të OE që do të ofertojë të përmbushë këtë kërkesë nga ana e AK – Autoritetit Kontraktues.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve tjera AK – Autoriteti Kontraktues konstaton që nuk qëndrojnë.

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruesit, shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit dhe analizës konkrete në mënyrë të drejtë të gjitha fakteve dhe provave të administruara, gjeti dhe konstatoi se Kërkesa për Rishqyrtim i parashtruesit aprovet si pjesërishtë e bauarë.

Andaj AK duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit Po ashtu duke pasur në konsideratë nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së lidhur me mënyrën më efikase, transparente do të bejë korigjimin e dosjes së tenderit konformë rregullave të prokurimit dhe LPP.

Shqipe Hoxha



Zyrtare Përgjegjëse e Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	651-24-2309-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Company Zuka Commerce Sh.p.k.
NUI	600112461
Adresa	Rr. Metush Krasniqi p.n.
Vendi	Gjilan
Kodi postar	60000
Numri Telefonit	044/125-938
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Muhadin Zuka
Adresa elektronike	shpkzuka@hotmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	29.04.2024

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

1. Publikimi i Njoftimit për Kontratë në ueb faqe të E-prokurimit: 05.04.2024
2. Procedurë e hapur
3. Lloji i kontratës - Punë
4. Vlera e parashikuar: 213,245.49 €
5. Vlera e parashikuar Lot 1: 31,705.07 €
6. Vlera e parashikuar Lot 2: 181.540.42 €
7. Kriteri për dhënien e kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
8. Permiresim i dosjes së tenderit dhe paramases – Lot 2: 29.04.2024
9. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 10.05.2024; Ora 14:00

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 të Ligjit Nr.04/L-042, Qëllimi;

2) Neni 6 të Ligjit Nr.04/L-042, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 të Ligjit Nr.04/L-042, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

Neni 69 të Ligjit Nr.04/L-042, Aftësia Teknike dhe/ose profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

PRETENDIMET ANKIMORE

Tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale

Kapaciteti teknik dhe profesional

FTD - Kërkesa 1 : Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i kanalizimeve), në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale për Lotin 2 prej 280,000.00 € së pari është tejkaluar vlera e kërkuar në raport me vlerën e parashikuar të këtij Lot-i.

Si dhe duke analizuar paramasën e këtij Lot-i (2) kemi vërejtur që 95% e pozicioneve në paramasë kanë të bëjnë me ndërtim të rrugëve e jo me kanalizim. AK sipas paramasës dhe normativave ligjore nuk do të duhej të kufizonte kërkesën vetëm në ndërtim të kanalizimeve por duhet të përfshijë të gjitha punët e natyrës së ngjajshme.

Ju lutem përmirësojeni këtë kërkesë duke e përshtatur me pozicionet e punëve në paramasë, pra me kontrata dhe referenca për ndërtim të rrugëve sepse kjo kërkesë e juaja është jo e arsyeshme me objektin e kontratës.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompensim i dëmeve materiale për shpenzimet procedurale, kompensim i fitimit të humbur nga kjo punë që do të kërkohet në vazhdim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

1. Introduction

2. Methodology

3. Results

4. Discussion

5. Conclusion

6. References

7. Appendix

8. Acknowledgements

9. Author Biographies

10. Correspondence

11. Contact Information